



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

Raport i konsultimeve buxhetore 2024

Buxheti është një plan i të hyrave dhe shpenzimeve për një periudhë të caktuar kohore që hartohet dhe rivlerësohet në baza periodike. Buxheti komunal është procesi kryesor i cili lejon komunat të arrijnë shumë qëllime në rrjedhën e tyre të veprimit. Prosesi i formulimit të një plani buxheti është një nga aktivitetet kryesore të çdo komune për vitin e ardhshëm me qëllim plotësimin e nevojave zhvillimore së bashku me nevojat e qytetarëve.

Buxheti si akt më i rëndësishëm komunal shqyrtohet dhe miratohet në Kuvend Komunal në baza vjetore bazuar në parashikime afatmesme tri vjeçare. Institucionet komunale kanë kompetenca që ndikojnë në kualitetin e jetës së qytetarëve.

Buxheti që hartohet çdo vit nga të hyrat e parasë publike, përcakton se çfarë projekte dhe shërbime do t'u ofrohen qytetarëve, andaj duhet të jetë i shpërndarë mirë dhe i konsultuar me qytetarët. Me konsolidimin e qeverisjes lokale, buxhetet komunale janë rritur dukshëm dhe janë bërë të rëndësishëm për zhvillimin e lagjeve dhe fshatrave.

Njëra ndër parimet bazë për një qeverisje të mirë është zotimi se do të mbahen dëgjime publike me qëllim të mbledhjes së prioriteteve nëpër secilin vendbanim varësisht prej kërkesave që kanë banorët, për t'i harmonizuar pastaj në draftim të politikave lokale përfshirë buxhetin.

Ligji për Menaxhimin e Financave Publike, neni 61 e obligon Kuvendin Komunal pas pranimit të propozim buxhetit të mbajë dëgjime buxhetore dhe më pas ta shqyrtojë dhe ndryshojë (siç e sheh të arsyeshme) draft buxhetin sipas inputit të qytetarëve, ndërsa Udhëzimi Administrativ për Transparencë në Komuna ofron detaje se si duhet të informohen qytetarët për takime publike, përfshirë dëgjimet buxhetore dhe detajon procedurat për mbarëvajtjen e tyre.

Në bazë të nenit 68, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, neni 61 paragrafi 2 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit Nr.03/L-048, në bazë të Statutit të Komunës, Kryesuesi i Kuvendit në koordinim

me Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, organizojnë dëgjime publike rreth përgatitjes së buxhetit të Komunës së Kaçanikut për vitin 2025.

Ecuria e procesit të dëgjimeve buxhetore për projekt buxhetin e vitit 2024

Komuna e Kaçanikut ka themeluar grupin punues për realizimin e procesit të dëgjimeve buxhetore për buxhetin komunal 2025. Grupi punues i mbështetur nga projekti DEMOS ka realizuar një punëtori një ditore për hartimin e planit të dëgjimeve buxhetore.

Plani i dëgjimeve buxhetore është hartuar dhe gjithashtu është publikuar në ueb faqen dhe rrjetet sociale të Komunës. Plani ka paraparë gjithsej 5 dëgjime buxhetore me grupe të ndryshme.

Hartimi i këtij propozim buxheti ka ardhur edhe pas mbajtjes së konsultimit publik me qytetaret për Kornizës Afatmesme Buxhetore të miratuar në Kuvendin e Komunës në mbledhjen e datës: 28 qershor 2024.

Komuna e Kaçanikut, përmes Zyrës së Informimit dhe Komunikimit me Publikun, gjatë këtij procesi, ka punuar me përkushtim të shtuar për të ftuar në këto takime buxhetore grupet e ndryshme të interesit. Gjatë kësaj periudhe është përdor edhe databaza e punuar një vit me parë në bashkëpunim me DEMOS, ku janë ftuar edhe grupet e ndryshme të interesit me të cilat janë mbajtur këto dëgjime buxhetore. Në fund të secilit njoftim janë publikuar e-mailat e zyrtarëve ku qytetarët kanë pasur mundësi t'i dërgojnë kërkesat, sugjerimet e tyre.

Publikimet për këto dëgjime buxhetore janë bërë këtu:

Uebfaqe:

<https://kk.rks-gov.net/kacanik/category/konkurset-njoftimet/konsultime-publike-konkurset-njoftimet/>

Facebook:

Të gjitha kërkesat e parashtruara në takimet fizike si dhe ato në formë elektronike, janë shqyrtuar nga Grupi Punues, ndërsa raporti i detajuar për kërkesat e pranuar apo refuzuara, është paraqitur në formë të plotë në shtojcën nr. 1 të këtij raporti.

Metodat e konsultimit	Data /	Numri i pjesëmarrësve	Numri i atyre që kanë dhënë komente, kërkesa / sugjerime	Shpjegimi se a po aprovohet kërkesa (nëse nuk aprovohet me dhënë shpjegimin pse jo)
Dëgjimi buxhetor me sektorin e Arsimit dhe Shkencës	11 korrik 2024	25	9 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa	Shumica e kërkesave janë pranuar dhe janë inkorporuar në projektbuxhetin e vitit 2025.
Dëgjimi buxhetor me sektorin e shëndetësisë	17 korrik 2024,	0	0	0
Dëgjimi buxhetor me të rinjtë, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të Shoqërive Kulturore Artistike, grupe jo formale artistike nga	19 korrik 2024,	15	3 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa	Shumica e kërkesave janë pranuar dhe janë inkorporuar në projektbuxhetin e vitit 2025.

komuna jonë dhe Klubet Sportive				
Dëgjimi buxhetor me sektorin e bujqësisë në Komunën e Kaçanikut	22 korrik 2024,	15	4 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa	Shumica e kërkesave janë pranuar dhe janë inkorporuar në projektbuxhetin e vitit 2025.
Dëgjim buxhetor me sektorin e turizmit, zhvillim ekonomik, planifikimit urban dhe infrastrukturë rrugore	26 korrik 2024,	20	4 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa	Shumica e kërkesave janë pranuar dhe janë inkorporuar në projektbuxhetin e vitit 2025.
Kërkesa të pranuar në mënyrë elektronike		1	27 Kërkesa online	Shumica e kërkesave janë pranuar dhe janë inkorporuar në projektbuxhetin e vitit 2025.

Projekt buxheti i vitit 2025, pas përmbylljes së procesit të dëgjimeve buxhetore, do të finalizohet dhe deri më 1 shtator 2024 do të procedohet për në Kuvendin e Komunës së Kaçanikut.

Shtojca – Tabela e detajuar me informatat për kërkesat e dhëna, arsyetimet për kërkesat e pranuar dhe të refuzuara.

NR.	Temat e dëgjimit buxhetor	Kërkesat / Sugjerimet / Komentet	Kush ka dhënë kërkesë / sygjerim për projekt buxhetin e vitit 2023	Statusi i kërkesës / sugjerimi (i pranuar, pjesërisht e pranuar apo nuk është pranuar)	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimin te komenteve është i detyrueshëm)
1).	Projektbuxheti i vitit 2025	Kërkoj nga DKRS që në bazë të mundësive të rrisin buxhetin në sferën e kulturës, rinisë dhe sportit me qëllim që të ju krijohen kushte më të mira OJQ-ve për zhvillimin e	Xhevdet Hysa	E pranuar	Drejtoria për cdo fillim vit i bën të gjitha përgatitjet për hapjen e thirrjes publike duke u bazuar edhe në rregullorën për ndarje të subvencioneve dhe ne ju përmbahemi kësaj rregullore .Gjatë

		aktiviteteve që ato kanë.			vlersimit të aplikacioneve komisioni bazohet në kriteret që i kërkon thirrja publike dhe rregullorja MF - NR - 04/2017 MBI KRITERET, STANDARDET DHE PROCEDURAT E FINANCIMIT PUBLIK TË OJQ-VE
2).	Projektbuxheti i vitit 2025	Kisha sugjeru që ndarja e subvencioneve të bëhet në bazë të meritave dhe sukseseve që tregojnë OJQ-të.	Afrim Bunjaku	E pranuar	Drejtoria për qdo fillim vit i bën të gjitha përgatitjet për hapjen e thirrjes publike duke u bazuar edhe në rregullorën për ndarje të subvencioneve dhe ne ju përmbahemi kësaj rregullore .Gjatë vlersimit të aplikacioneve komisioni bazohet në kriteret që i kërkon thirrja publike dhe rregullorja MF - NR - 04/2017 MBI KRITERET, STANDARDET DHE PROCEDURAT E FINANCIMIT PUBLIK TË OJQ-VE
3)	Projektbuxheti i vitit 2025	Jam anëtarë i SHKA „Tingujt e Vendlindjes” por që jam edhe adhurues i muzikës ROCK ku me një grup jo formal ne bëjmë muzikë edhe të këtij zhanri.Ne si grup nuk jemi të regjistruar si OJQ dhe më intereson të dijë se a mundemi me apliku si grup	Arlind Hysa	Gjysmë e pranuar	Deri më tani jane përkrahur OJQ-të që janë të regjistruara por që në të ardhmën do e shohim edhe këtë mundësi që me pas drejtë aplikimi edhe individi.

		joformal apo edhe si individ ngase të rinjët e qytetit tonë e dojnë ROCK-un dhe ne së bashku edhe me disa grupe tjera jo formale mundemi të organizojmë aktivitete të këtij zhanri.			
4)	Projektbuxheti i vitit 2025	Vazhdimi i zgjerimi i rrugës 'Emsale Frangu' dhe ndërtimi i trotuarit nga Shkolla Fillore 'Emin Duraku' në Dushkajë deri në fund të rrugës;-	Faton Zharku	E pranuar	Ky projekt do të shqyrtohet të realizohet përmes kodit të projektit "Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugëve lokale urbane"
5)	Projektbuxheti i vitit 2025	Zgjerimi i rrugës dhe ndërtimi i trotuarit nga Xhamia e Dëshmorëve deri te tuneli i trenit në Runjevë;-	Faton Zharku	E pranuar	Ky projekt do të shqyrtohet të realizohet përmes kodit të projektit "Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugëve lokale rurale"
6)	Projektbuxheti i vitit 2025	Vazhdimi i rregullimit të shtratit të lumit Nerodime nga Xhamia e Dëshmorëve në gjatësi prej 250 m;-	Faton Zharku	E pranuar	Komuna ka të hartuar projektin ekzekutiv për vazhdimin e rregullimit të shtratit të lumit Nerodime në gjatësi totale 6383.72m . Bazuar në mundësitë buxhetore të komunës, projekti nuk mund të përballohet si tërësi, por do të shikohen mundësitë e financimit nga ministritë e linjës
7)	Projektbuxheti i vitit 2025	Vazhdimi i rregullimit të	Faton Zharku	E pranuar	Komuna ka të hartuar projektin ekzekutiv

		shtratit të lumit Lepenc në Bob në gjatësi prej 250 m;			për vazhdimin e rregullimit të shtratit të lumit Lepenc në gjatësi totale 5654.77m . Bazuar në mundësitë buxhetore të komunës, projekti nuk mund të përballohet si tërësi, por do të shikohen mundësitë e financimit nga ministritë e linjes
8)	Projektbuxheti i vitit 2025	. Ndërtimi dhe asfaltimi i segmentit rrugor, Stagovë - Kaçanik i Vjetër;	Faton Zharku	E pranuar	Këtë vit është parapare ndërtimi dhe asfaltimi i segmentit rrugor Runjevë-Stagovë në gjatësi 1800m kurse në vitet në vijim, bazuar në projektin e detajuar, do të implementohet edhe segmenti Stagovë - Kaçanik i Vjetër
9)	Projektbuxheti i vitit 2025	Zgjerimi i rrugës përgjatë përroit të Rakocit;	Faton Zharku	E pranuar	Ky Project është i koduar në buxhetin e vitit 2024 dhe janë ndare mjete 72,279.00€.
10)	Projektbuxheti i vitit 2025	Ndërtimi i trotuarit përgjatë magjistrales Kaçanik-Ferizaj për banorët e lagjes Dushkaja;	Faton Zharku	E pranuar pjesërisht	Në planifikimet e ardhshme të komunës së Kaçanikut do të shqyrtohet mundësia që fillimisht të hartohet projekti detal që më pas, bazuar në koston e

					paraparë të projektit të shikohen mundësitë për bashkëfinancim me Ministrinë e Infrastrukturës ngase rruga magjistrale Ferizaj-Kaçanik është në kompetence të kësaj ministrie.
11)	Projektbuxheti i vitit 2025	. Ndërtimi i trotuarit përgjatë magjistrales Kaçanik-Hani i Elezit për banorët e Bobit;	Faton Zharku	E pranuar pjesërisht	Në planifikimet e ardhshme të komunës së Kaçanikut do të shqyrtohet mundësia që fillimisht të hartohet projekti detal e më pas, bazuar në koston e paraparë të projektit të shikohen mundësitë për bashkëfinancim me Ministrinë e Infrastrukturës ngase rruga magjistrale Kaçanik-Hani i Elezit është në kompetencë të kësaj ministrie.
12)	Projektbuxheti i vitit 2025	Vendosja e reflektorëve në drejtim të Gurit të shpëmë për ndriçimin e saj gjatë natës;	Faton Zharku	E pranuar	Si ide është e mirë por fillimisht duhet të shqyrtohet dhe analizohet arsyeshmëria dhe kostbenefiti i këtij projekti për banorët e komunës së Kaçanikut.
13)	Projektbuxheti i vitit 2025	12. Ndërtimi i shtegut për këmbësorë dhe çiklistë nga	Faton Zharku	E pranuar	Projekti është i koduar në listën e investimeve kapitale të komunës së

		Kaçaniku deri në Hanin e Elezit përgjatë lumit Lepenc;			Kaçanikut për vitin 2024, por kostoja e projektit tejkalon mundësit buxhetore të komunës sonë.
14)	Projektbuxheti i vitit 2025	. Instalimi i Free Internet Zone në sheshin e qytetit;	Faton Zharku	E pranuar	Ideja e Free Internet Zone në këtë lokacion dhe lokacione tjera te qytetit do të shqyrtohet të realizohet përmes projektit Smart City, që aktualisht komuna është duke e bërë studimin e fizibilitetit të këtij projekti.
15)	Projektbuxheti i vitit 2025	14. Pastrimi dy herë në vit i shtratit të lumit Nerodime nga vendi ku bashkohen lumenjtë deri te Xhamia e Dëshmorëve;	Faton Zharku	E pranuar	Praktika e pastrimit të shtratit të lumit Nerodime, është duke u zbatuar tash e disa vite. Me mjetet buxhetore të komunës është duke u bërë pastrimi një herë në vit.
16)	Projektbuxheti i vitit 2025	Pastrimi me ujë çdo ditë në sezonin e verës (Korrik-Gusht) i bulevardit 'Ismail Raka'	Faton Zharku	E pranuar	Pastrimi i bulevardit dhe rrugëve të qytetit me ujë po bëhet sipas nevojës përmes kontratës "Mirëmbajtja verore e rrugëve lokale"
17)	Projektbuxheti i vitit 2025	Ndarja e një shtese të njëhershme për familjet në rastin e lindjes së fëmijëve, për fëmijën e parë, 100 euro, për fëmijën e dytë, 200 euro, për fëmijën e tretë, 300 euro, etj.	Faton Zharku	E pa pranuar	Për shkak të mundësive buxhetore kjo kërkesë momentalisht nuk mund të realizohet.

18)	Projektbuxheti i vitit 2025	Vendosja e TV digjital në sheshin e qytetit;	Faton Zharku	E pranuar	Kjo ide do të shqyrtohet të realizohet në vitet në vijim duke ndërlidhur edhe me aktivitete tjera vjetore të parapara nga komuna për festat dhe ditët e shenuara
19)	Projektbuxheti i vitit 2025	Shtimi i shërbimit të endokrinologjisë në kuadër QKMF-së;	Faton Zharku	E pa pranuar	Specialisti i Endokrinologjisë nuk është i paraparë sipas statutit të QKMF-së, kurse me UA 04/2020 janë paraparë të bëhen analizat e hormoneve të tiroidesë T3,T4 dhe TSH-ja!
20)	Projektbuxheti i vitit 2025	Mbjellja e jorgovanit nëpër qytet;	Faton Zharku	E pranuar	Tashmë janë krijuar vende dhe vazo betoni në shëtitoret përgjatë lumit Nerodime nga ura e Konakut deri te xhamia e dëshmorëve, ku mund të mbjellen lule të ndryshme njëvjeçare dhe shumëvjeçare.
21)	Projektbuxheti i vitit 2025	Ndërtimi i parkut në lagjen Dushkaja pas Shkollës Fillore 'Emin Duraku'	Faton Zharku	E pranuar	Trajtimi i hapësirave publike për ndërtimin e parqeve të ndryshme në lokacione ku ekziston mundësia është duke u implementuar çdo vit përmes kodit të projektit "Ndërtimi i

					parqeve dhe hapësirave publike”
22)	Projektbuxheti i vitit 2025	18. Organizimi i turneut memorial të shahut 'Hakif Jusufi' me rastin e ditës së Çlirimit të Kaçanikut;	Faton Zharku	E pranuar	DKRS në bashkëpunim me kryetarin e komunës organizon një sër aktivitetesh kulturore, artistike e sportive të cilat organizohen në bashkëpunim me OJQ-të në këtë rast me KSH Lepenci , ku edhe turneun Memorial Hakif Jusufi jemi të gatshëm ta mbështesim një kërkesë të tillë në vitet në vazhdim
23)	Projektbuxheti i vitit 2025	Themelimi vjetor i çmimit letrar për poezi dhe letërsi 'Bedri Hysa';	Faton Zharku	E pranuar	DKRS mbështet me subvencione organizatat kulturore dhe mirëpret cdo iniciativë e do të mbështes edhe Themelimin vjetor të çmimit letrar për poezi dhe letërsi 'Bedri Hysa';
24)	Projektbuxheti i vitit 2025	Kino në Shtëpinë e Kulturës;	Faton Zharku	E pa pranuar	Të gjithë qytetarët e Komunës së Kaçanikut janë në dijeni se objekti i Shtëpisë së Kulturës momentalisht nuk i plotëson të gjitha kushtet për KINO pasi që edhe sistemi elektrik i vjetërsuar na e pamundëson një gjë të tillë. Jemi në pritje të një projekti për renovim të tërësishëm.

25)	Projektbuxheti i vitit 2025	1. Ndërtimi i urës për automjete dhe këmbësorë mbi lumin Nerodime te Xhamia e Dëshmorëve në Kaçanik;	Faton Zharku	E pranuar	Ura për këmbësorë dhe automjete, mbi Lumin Nerodime do të përfundohet brenda këtij viti.
26)	Projektbuxheti i vitit 2025	Inicimi i procedurës për hartimin e Hartave Zonale	Faton Zharku	E pranuar	Ne lidhje me hartat zonale pritet që brenda këtij viti të kemi kontratën e lidhur me një ndërmarrje për hartimin e projektit Hartat Zonale për Komunën e Kaçanikut.
27)	Projektbuxheti i vitit 2025	Krijimi i një ose dy paralele të mjekësisë në kuadër të shkollës së mesme;	Faton Zharku	E pa pranuar	Në kuadër të planifikimit të DKA-së, nuk parashihet që të hapen paralele të mjekësisë. Arsye kryesore është mungesa e kuadrit dhe zvogëlimi i numrit të nxënësve.
28)	Projektbuxheti i vitit 2025	Shpallja zonë turistike e vendbanimeve, një pjesë malore e Bobit, Gajra, Ivaja, Kotlina, Shtraza, Gllloboçica, Gjurgjedelli, Llanishta, Kërbliq, Dërnogllava.	Faton Zharku	E pranuar	Me miratimin e Planit të ri Zhvillimor Komunal i cili është në finalizim e sipër, parashihen të shpallen zona të reja turistike të cilat gjenden në fshatrat: Kotlinë, Ivajë, Kërbliq, Krivenjevë dhe Sllatinë, ndërsa zona turistike aktuale në Strazhë do të zgjerohet. Gjithashtu do të ketë një zonë turistike në qytet në pjesën e zonës urbane saktësisht në Grykë të Kaçanikut si dhe pjesa e Gurit të Shpuar. Komuna e Kaçanikut poashtu ka propozuar që me Planin e ri Kombëtar për Parkun Nacional "Sharr", të parashihet një zonë

					turistike në Luboten dhe ndërtimi i teleferikut në këtë pjesë .
29)	Projektbuxheti i vitit 2025	Hartimi i projektit të teleferikut nga Bobi deri te Guri i shpumë	Faton Zharku	E pa pranuar	Sa i përket hartimit të projektit të teleferikut Bob-Guri i Shpumë me Planin e ri Zhvillimor Komunal nuk parashihet në këtë distancë ndërtimi i teleferikut, por i njëjti kemi propozuar të ndërtohet nga fshati Strazhë për në Luboten, meqë në atë pjesë lidhen me mire zonat turistike dhe mendojmë që tërheqja e vizitoreve nga vendet e tjera do të jete me i qëlluar aty.
30)	Projektbuxheti i vitit 2025	A është mendu me kalu në ndonjë sistem tjetër ngrohja e shkollës,qoftë me pompa termike.	Atdhe Neziri	E pranuar	Në kuadër të projektit për energji eficiente hynë pompa termike, SHML"Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka" është shkolla e parë e cila do të bëhet me panele solare.
31)	Projektbuxheti i vitit 2025	A është paraparë buxhet për trajnimin e mësimeve për me punu në digjitalizimin në shkolla? Theksoj se janë nevojat për trajnimin e mësimeve.	Agim Mjaku	E pranuar	Çështjen e trajnimeve e kam parapa prej mallrave-shërbimeve dhe subvencioneve. Në kuadër të subvencioneve parashihen trajnimet gjë ka pas thirrjet publike, kanë filluar trajnime dhe ka me pas në vazhdimisht.

32)	Projektbuxheti i vitit 2025	Kërkon rrethoj për oborrin e shkollës "Dituria" në Ivajë.	Nexhadi Luta	E pranuar	Kjo çështja e rrethojës është paraparë në projekt buxhetin e vitit 2025.
33)	Projektbuxheti i vitit 2025	Kërkoj rrethojën e shkollës fillore "Idriz Seferi" në Bob, e cila është problem i tepruar dhe se klasat janë 50m ² për 30 nxënës, në vazhdimësi ata rriten edhe se hapësira mbetet e pamjaftueshme.	Florie Berisha	E pa pranuar	Në "Idriz Seferi" Bob: 1. Ka fillu ndërtimi i sallës së edukatës fizike, 2. Do të rregullohen shkallët që ke pas të drurit, 3. rregullohen tualetet e reja dhe linjat higjienike, 4. garazhimi për dru dhe nxemje.
34)	Projektbuxheti i vitit 2025	A jeni i kënaqur me produktin që del prej shkollave?	Kastriot Bushi	E pranuar pjesërisht	Ne kemi ofruar infrastrukturë, ka hapësirë për me u bërë më mirë, tash është koha që të shihen sukseset.
35)	Projektbuxheti i vitit 2025	Kërkoj 35,400.00€ që të gjitha klasat të paisen me klima dhe tabela digjitale 13,000.00€ për sallën e edukatës fizike.	Shefki Guri	E pranuar pjesërisht	Në vazhdimësi mbetet me pa se si po rrjedhin gjërat gjatë investimit, e varësisht prej kërkesave të arsyeshme dhe në bashkëpunim me drejtorin Zahir Doda mundemi mi lëviz investimet. Sa i përket sallës së edukatës fizike jemi në dijeni që është e domosdoshme, ne jemi duke punuar në atë drejtim por nuk kam

					diçka konkrete për me premtu.
36)	Projektbuxheti i vitit 2025	Kërkon një garazhim për dru, një hidrofor dhe klasat të pajisen me perde.	Nazmi Gashi	E pranuar	Perdet janë të paraparë në këtë vit kryhen në ato shkolla të cilat kanë mbet pa u paisur me perde, çështja e hidroforit e druve nuk është e nivelit të këtij takimi publik ato sanohen.
37)	Projektbuxheti i vitit 2025	Kërkoj që të investohet në kulmin e shkollës sepse ka filluar të pikë vende vende.	Samet Luma	E pa pranuar	Si problem te vetëm qe ke, unë i kam parapa mjetet për meremetimet e domosdoshme, problem madhor për mua është SHFMU "Ali Asllani" nxënësit janë në pozitën ma të keqe të mundshme, dhe SHFMU "Emin Durak" kanë ngec punët në çdo segment, na kemi përmbush të gjitha obligimet sa i përket drejtorisë së arsimit dhe drejtorisë së urbanizmit.
38)	Projektbuxheti i vitit 2025	Kërkoj që fermerët mos të mbështeten me serra të vogla por të mbështeten me serra të mëdha me sipërfaqe prej 2.5m ² , 500m ² , ne mënyrë që fermerët të fermerët të fillojnë të prodhojnë për treg. Gjithashtu kërkoj të vazhdohet mbështetja me mekanizëm bujqësor, por të ulet kriteri për sipërfaqen e tokës bujqësore, pasi që ende kemi problem	Shyqeri Vishi	E pranuar pjesërisht	Për kërkesat e parashtruara ju përgjigj drejtori Dullovi duke i informuar se deri më tani kërkesat për serra të vogla kanë qenë të shumëta, në mënyrë që qytetarët t'i sigurojnë prodhimet për nevoja familjare, ne kemi diskutuar edhe me zyrtarët e sektorit të bujqësisë lidhur me mundësinë e subvencionimit me serra në sipërfaqe më të mëdha. Mbetet të shohim në vitet në vijim varësisht nga kërkesat e qytetarëve, meqenëse kemi pas raste kur kemi

		me çështjen e pronësisë dhe mundësisht monitorimi të jetë në vazhdimësi për njerëzit përfitues që keqpërdorimet të jenë sa më të vogla.			shpallur njoftimin për aplikim edhe për serra të mëdha, por kemi pas mungesë të aplikuesve. Sa i përket uljes së kriterit për sipërfaqe për mbështetje me mekanizëm mbetet të shohim në të ardhmen.
39)	Projektbuxheti i vitit 2025	Kërkoj që sipas mundësive fermerët të mbështetën me lopë qumështore ,në mënyre që fermerët të rrisin fermat e tyre për prodhimin e qumështit.	Rrustem Zenuni	E pa pranuar	Sa i përket mbështetjes me lopë qumështore, në bazë të së kaluarës fermerët nuk i kanë përfillë edhe shumë kushtet.
40)	Projektbuxheti i vitit 2025	Propozoj që të pastrohet kanali ekzistues për kullimin e moqalit të krijuar ,në Provoli te Pallosht.	Fadil Guri		
41)	Projektbuxheti i vitit 2025	Lidhur me mbikëqyrjen e kanalit të ujitjes prej fshatit Doganaj deri në fshatin Provoli,te Cenët kanali është lëshuar nën nivelin e ujit dhe uji derdhet nuk shfrytëzohet për arsye të rënies së nivelit të ujit.	Hamdi Deda	E pa pranuar	Sa i përket vërejtjes lidhur me mbikëqyrjen e kanaleve të ndërtuar prej betoni drejtori Dullovi ju përgjigj se kanalat e ujitjes duhet të mirëmbahen dhe pastrohen nga personat që posedojnë prona për ujitje ngase komuna nuk i mirëmban kanalet e ujitjes.Para ndërtimit të kanlave keni qenë në gjendje t'i hapni dhe t'i mirëmbani çdo herë e tani me mure prej betoni nuk po keni mundësi me i pastru,mbikëqyrja duhet të jetë nga ju e jo nga komuna. Mund të themi se ka ra interesimi për me punu tokën e jo

42)	Projektbuxheti i vitit 2025	Gjatë diskutimit fillimisht përsëndeti stafin e drejtorisë lidhur me mbështetjen e subvencioneve për sipërfaqe të vogla prej 0.5ha e mandej pati kritika rreth ndarjes së subvencioneve të mekanizmit bujqësor. Arsyeja e kritikës ishte për shkak të mos përfitimit të mekanizmit të frezave.	Bedri Tupani	E pa pranuar	mungesa e mbikëqyrjes. Lidhur me kritikën e tij gjoja për mospërfitimin e frezave, fjalën e mori shefi i sektorit Zylfi Koxha të cilit iu drejtua me fjalët: Ju keni qenë përfitues i mëhershëm i makinës spërkatëse, andaj ne nuk kemi mundësi që vazhdimisht të mbështesim të njëjtin fermer sa herë që të ofrojmë subvencione ngase nuk kemi buxhetin e mjaftueshëm për t'i mbështetur të gjithë aplikuesit. Vazhdimisht e bëjmë përzgjedhjen e fermerëve, por në pamundësi të mbështetjes për të gjithë. Arsyeja buxhet jo i mjaftueshëm.
43)	Projektbuxheti i vitit 2025	E rëndësishme është të shqyrtohen mirë, është një burim nga mali në lagjen tonë me të cilën njerëzit të furnizohen me ujë, është premtim i kahershëm zgjidhja e problemit të ujit dhe disa projekte që lidhen me qytetarët.	Remzi Reka	E pa pranuar	Bifurkacioni është kompani e licensuar për trajtimin e ujit nga ana e nivelit qendror. Ne si komunë kemi shumë investime në këtë drejtim dhe të njëjtit i kemi dorëzuar Bifurkacionit, për menaxhimin e punës në teren i takon konkret Bifurkacionit.
44)	Projektbuxheti i vitit 2025	E rëndësishme është të shqyrtohen mirë, është një burim nga mali në lagjen tonë me të cilën njerëzit të furnizohen me ujë, është premtim i	Remzi Reka	E pa pranuar	Investimet në ujësjellës 2016-2024, diku gjysmë milioni janë investim në ujësjellës. Ujë kemi të mjaftueshëm mirëpo uji i pijshëm po keqpërdoret për bahçe, kopshte, serra etj.

		kahershëm zgjidhja e problemit të ujit dhe disa projekte që lidhen me qytetarët.			Tek rruga në fjalë rezervari nuk e përballon atë kuotë nuk e furnizon. Investimet në ujësjellës janë sugjeru të bëhen në koordinim me kompaninë në këtë rast me Bifurkacionin. Nga kompania projektuese kemi hartuar projektin tek banesat afër stacionit të autobusëve, te lagjja e Çakajve dhe në fshatin Duraj.
45)	Projektbuxheti i vitit 2025	Ju lutem tek hapësirat e gjelbërta të parashihen më tepër mjete sipas buxhetit, shoh shume rrugë urbane e rurale që do të asfaltohen, andaj të largohen disa rrugë dhe të shtohet buxheti tek hapësirat.	Sami Stagova	E pranuar	Ndërtimi i trotuarit ,shtegu i çiklizmit, rruga "Adem Jashari" do t'i dërgohet kompanisë për hartim të projektit.
46)	Projektbuxheti i vitit 2025	Kërkesa është për kanalizime fekale, ndriçimi publik për rrugën "Fatmir Huruni dhe Raif Koraçi"	Fatmir Bunjaku	E pranuar	Kanalizimet fekale janë parapa dhe do të rregullohen këtë vit. Ndriçimi publik në lagje nuk bëhet dhe ka do që të shihni dijeni që ka investuar vet lagjja.
47)	Projektbuxheti i vitit 2025	Subvencionet po bëhen për biznese të vogla etj. Mund të bëhen kur komuna parasheh që në pikat kryesore si shembull nëse dikush do të investoj në një	Sami Stagova	E pranuar pjesërisht	Kemi filluar të investojmë duke rregulluar infrastrukturën në mënyrë që të lehtësojmë investime të reja.

		restaurant në një pikë të saktuar a mund ta subvencionoj komuna në këto raste sepse kjo ndodhë në shumë vende sidomos në pikat e caktume për zhvillim.			
48)	Projektbuxheti i vitit 2025	Ndarja e subvencioneve të bëhet për një projekt për te subvencionet vetëm 80% të projektit dhe OJQ të gjenden në pjesën tjetër të mjeteve,ndarja e subvencioneve të bëhet vetëm për një projekt pra të subvencionohet 80% e projektit dhe nga OJQ të gjenden pjesa tjetër e mjeteve.	Sami Stagova	E pranuar	<p>OJQ paraqesin kërkesa të panumërta dhe vlera nëse ulet nga ana jonë ata shprehin menjëherë pakënaqësi. Mandej OJQ duhet të kenë më tepër staf dhe të llojnë në pjesë tjera.</p> <p>Subvencionet që ndahen nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik i përkrahin bizneset mirëpo nuk është ide e keqe të subvencionojmë edhe bizneset me investime të caktume me prioritet për komunën.</p>
49)	Projektbuxheti i vitit 2025	Sa i përket hapësirave publike (25,000),hapësira publike përball kalasë dhe rrafshi në Doganaj mendoj që s'bashku mund të analizojmë dhe të trajtojmë në mënyrë ma të mirë. Tek Çami duhet menduar rrugën dhe parkingun, përgjatë lumenjëve,mirë kishte me qenë me planifikuar shtigjet e këmbësorëve	Sami Stagova	E pranuar pjsërisht	<p>Pasi komuna ka dhënë disa prona në shfrytëzim andaj ndiejmë obligim me rregullu rrugën te Silkapori,Kukaj. Çdo projekt që po dërgohet në ministri nuk po marrim përkrahje nga ministria përkatëse. Në Doganaj mirë është të përfshihet ndonjë teren sportiv ose...</p>

		<p>Segmenti Kaçanik-Hani i Elezit. Rruga Kaçanik-Stagovë-Kaçanik i Vjetër e qëlluar për mendimin tim. Cili është planifikimi për shkollën "Emin Duraku" dhe rruga Kërbliq, a duhet lënë kode edhe pse financohet nga ministria.</p>			
50)	<p>Projektbuxheti i vitit 2025</p>	<p>Ka një disbalans në mes projekteve dhe prioritetëve. Trotuari tek restaurant Natyra besoj se do të shkoj më larg dhe të vazhdohet deri te lagjja Prushaj, pasi më tepër funksionale është në atë pjesë. Nga gjendja në teren rrugët kanë ndriçim publik por nuk mirëmbahen dhe nuk funksionojnë. Në fshatin nga vij unë në vete po e mirëmbajmë ndriçimin publik. Rruga "Adem Jashari", në Stagovë mendoj që shtegu i çiklizmit nuk duhet të jetë në këtë rrugë, pse mos të jetë në rrugën që lidh qytetin dhe fshatin Stagovë. Vendosja e paneleve diellor, ndërtimi i urave mbi</p>	<p>Qendrim Vogliqi</p>	<p>E pranuar pjesërisht</p>	<p>Do të kompletohet hapësira te varrezat e dëshmorëve sepse duhet rregulluar ashti siç e meritojnë ata. Tash është kontrata për ndriçim publik do të filloj në zonën urbane pastaj rurale të mënjanohem defektet. Trotuari te restaurant Natyra do të fillohet si fazë e parë deri te Lushi. Shtegu i çiklizmit në Dushkaj dhe trotuari është kërkesë e shumë personave mirëpo aty duhet procesi i shpronësimit.</p>

		<p>lumenj,asfaltimi i rrugëve rurale,kemi disa kërkesa për rrugica ndoshta në vlerë 30,000.00€,andaj ju lutem të shikoni mundësinë për realizimin e atyre kërkesave.Çka do të bëhet tek projekti "Varrezat e Dëshmoreve"</p>			
--	--	--	--	--	--

Përgatiti - Drejtorja e Financave, kryesues i grupit

Fitore Vishi

